



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 82-të, të mbajtur më datë 14.02.2023 morri,

## VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-3824/1 datë 09.10.2021, e krijuar me vetiniciativë , për shkëljen e dispozitave të nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga \_\_\_\_\_, ish ushtrues detyre zëvendës drejtor në \_\_\_\_\_, NDËRPRITET.

Konstatohet se pas kundërvajtjes së lëshuar me urdhërpagesë me numër 08-6960/2 të datës 12.07.2022, është vepruar nga ana e të theksuarit, gjegjësisht është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda është regjistruar sipas numrit 08-3824/1 të datës 09.10.2021 është formuar me vetë iniciativë të sajë.

KSHPK-ja, nga inspektimi në Gazetën Zyrtare të RMV-së numër 51/2021 ka konstatuar se \_\_\_\_\_ me Vendim nr.14-2731/1 datë 23.02.2021 është shkarkuar nga detyra e ushtruesit të detyrës së zëvendës drejtorit të

Agjencisë \_\_\_\_\_ dhe brenda afatit të përcaktuar me ligj pas përfundimit të pozitës nuk ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK.

Për sa më sipër, KSHPK-ja i ka lëshuar personit të përmendur një urdhërpagesë kundërvajtëse nr. 08-6960/2 datë 12.07.2022, për veprën penale të kryer nga neni 82 paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i dënuar sipas nenit 109 të të njëjtit ligj.

Nga ana e personit të emëruar në afatin e paraparë me ligj është vepruar, gjegjësisht është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti:A.Ç.

Miratoi: Mr. Vladimir Georgiev anëtar në KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
NËNKRYETARË,  
Katica Nikolovska**